



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARTEVE

**Lenda:** Sqarim për DST.

**Drejtuar:** Operatoreve ekonomike,

Autoriteti Rrugor Shqiptar, në bazë të pikës 2 të nenit 42 “Sqarime dhe ndryshime në dokumentat e tenderit” të ligjit 9643, datë 20.11.2006, si dhe në rekomandimet e APP-së, njofton operatorët ekonomikë të interesuar se në procedurën e prokurimit me objekt : **Ndërtim i Ures së Zemblakut”, me fond limit 43.049.588,39 lekë pa TVSH. Dhe numer reference REF-40512-10-22-2019, bejme keto sqarime:**

**1.Në kriterin Kapaciteti teknik: pika 2.3.9 bejme sqarimin.**

Në pikën 2.3.9 AK ka kërkuar : *Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat*

- ISO 9001 – 2015 (Menaxhimi i cilesise)
- ISO 14001 - 2015 (Menaxhimi i mjedisit)
- OHSAS 18001 - 2007 (Menaxhimi i shendetit dhe sigurise se Punonjesve ne pune)
- PASS 99-2012 (Sistemi i Integruar i Menaxhimit)
- ISO 39001 - 2012 (Menaxhimi i sigurise rrugore)...

*Organizmi certifikues të jetë i akredituar për këto standarte nga organizmi kombëtar i akreditimit (DPA) ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë të perditesuar/ të vlefshme dhe aktive . Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthim në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.*

**Sqarojme se ;**

Per certifikatën OHSAS 18001 - 2007 (Menaxhimi i shendetit dhe sigurise se Punonjesve ne pune), operatori ekonomik mund të paraqesë certifikatën OHSAS - 18001 (Sistemi i Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurisë në Punë) të vlefshme, ose certifikatën ekuivalente të njohur nga Standardet Shqiptare ISO 45001-2018.

**2.Per kapacitetin ekonomik dhe financiar: pika 2.2.2**



Në pikën 2.2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, AK ka kërkuar : Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate tre viteve te fundit 2016, 2017 dhe 2018. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të tre viteve të fundit, të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet , ne te cilat duhet te rezultojte se nuk ka dale me humbje te pakten ne dy vite te njepasnjeshem si dhe te shoqeruara me akt ekspertizen e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar.

### **Sqarojme se ;**

Në lidhje me kërkesën, për Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, sqarojme se, operatorët duhet të paraqitet Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: b) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

### **Njesia e Prokurimit**

- Miranda Shkurti
- Adja Sefa
- Astrit Ndreu

